



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 767 / Prot.
7

Patos, më 24/04/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 22 PRILL 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30


Dëgjesë publike me temë: "Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njostimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026".

Pjesëmarrës: Kryetari i bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, dhe *rreth 26 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të banorëve të qytetit të Patosit)*.

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028"**

Prill 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2028”, jemi këtu sot për të dëgjuar të gjitha kërkesat që ju mund të keni kundrejt bashkisë Patos. Unë e deklaroj këtë dëgjesë publike të hapur dhe ju ftoj të paraqisni kërkesat tuaja lidhur me hartimin e buxhetit.

Kryetar i fshatit Rerës, z. Shaban Ruçaj– përvendetje të gjithëve! Në të gjithë territorin e bashkisë Patos është bërë një punë shumë e rëndësishme dhe në fshatin tonë janë bërë shumë



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

punë. Janë rregulluar varrezat, rrugët e brendshme dhe shumë e shumë ndërhyrje të tjera. Megjithatë përsëri ka kërkesa të tjera nga qytetarët dhe komuniteti. Janë disa rrugë të brendshme që kanë ngelur dhe unë kisha një kërkesë lidhur me rrugën nga Banaj deri te kabina në Rrëshen që është shtruar me çakull sikur të nivelohej dhe të hidhej një shtresë pasi është e rëndësishme për tu vendosur në plan. Rruja e Rrapushajt është në gjendje të keqe dhe nuk hyn dot. Kjo rrugë duhet shtruar dhe rregulluar, pasi aty ka familje që banojnë. Panelet diellor nuk janë vendosur dhe ato janë në plan punë, madje unë kam shpresë që do vendosen. Kërkojmë që edhe rruja të shtrohet te varrezat e reja. Gjithashtu është bërë edhe një shpërndarje e elektrikut me kabllat në zonën tonë dhe unë kërkoj ndihmën tauj edhe për blloqet më lart pasi materialet kanë mbaruar dhe ka ngelur edhe një pjesë, një familje në fund në Biçakaj. Edhe shtylla që ka ngelur te Velikua ka problem dhe duhet një shtyllë për të vendosur për të bërë shpërndarjen.

Kryetar i fshatit Rusinj, z. Ajet Bregu- përshëndetje të gjithëve! Si fillim ju falenderoj për punët e bëra deri tani dhe një Rusinj janë lënë gjysëm rrugët. Kemi një rrugë në lagje, në Rusinj që ka pothuajse 30 vjet që atje nuk është hedhur asnjeherë asnjë material për ta



**Kryetar i fshatit Rusinj
z. Ajet Bregu**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

rregulluar. Një problem tjeter lidhet me pastrimin e koshave të mbeturinave pasi duhet të vij makina më shpesh për pastrim. Gjithashtu kemi problem edhe me ndriçimin, pasi na duhet disa shtylla dhe drita për ndriçimin e zonës.

Kryetar i shoqatës Naftëtari, z. Musa Goxhaj- Përshëndetje! Kisha disa kërkesa lidhur me këndin e lojërave pasi këndet kanë patur probeme me cilësinë e materialeve kur janë ndërtuar



**Kryetar i shoqatës Naftëtari
z. Musa Goxhaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

me para dhe nuk kanë zgjatur shumë, por janë dëmtuar. Nëse është e mundur të ndërtohen këndet për fëmijët dhe të krijohen kushtet për ta. Gjithashtu nëse është mundësia të krijohet ndonjë kuotë për anëtarët e vjetër të naftëtarëve për riparimin e banesave, pasi kanë dal shpejt në pension dhe nuk kanë mundësi ekonomike t'i riparojnë vet. Kërkesë tjeter kam mbi mundëisnë e punësimit të naftëtarëve të vjetër. Megjithëse kohët e fundit ka pasur punësime edhe prej tyre, por le të shikohen pak me përparësi.

Kryetar i fshatit Dukas, z. Ilmi Myftari – Lidhur me problemin e lisenit të lagjes Dukas



**Kryetar i fshatit Dukas
z. Ilmi Myftari**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

unë kam ngritur si problem dhe herë tjetër dhe kërkojmë rrugën për të lidhur dy zonat, pasi kishin një urë qytetarët që kalonin dhe ajo është dëmtuar. Në lidhje me varrezat dua të shikohet mundësia për të vendosur një çezëm pasi qytetarët që vizitojnë varret e familjarëve marrin ujë me vete me bidona. Gjithashtu kërkoj të ndërtohet edhe një tualet publik për qytetarët. Edhe të klubi i pensionistëve të rregullohet ambienti dhe të ndërtohet ky tualeti publik për banorët.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- përvendosje! Faleminderit të gjithëve që keni ardhur. Për sa i përket investimeve të pjesës tjetër të këtij viti apo vitit të ardhshëm po filloj nga qyteti dhe më pas me zonat e tjera. Aktualisht është duke u mbyllur projekti për lagjen 1 maj dhe është një nga lagjet e mëdha. Në të gjithë blloqet e pallateve është bërë ndërhyrje. Një investim që fillon ndoshta edhe këtë javë është pjesa e rrugës “Thimi Sinjari”, komplet



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

blloku që është përboll pallatit të Kulturës dhe pjesa e mbetur e vreshtit që do filloj shumë shpejt. Gjithashtu ne jemi duke parë mundësinë dhe jemi duke planifikuar projektin e fushës së zezë që do rikthehet siç ka qenë me një ndryshim të vogël që mos të jetë vetëm fushë volejboll, por edhe futbolli. Te lagija e Re te fusha në fund do parashikohet si një park dhe aktualisht po bëhet projekti dhe do shikohet për mundësi financimi. Lidhur me lagjen “29 Marsi” te pjesa poshtë rrugës janë paashikuar të gjitha rrugët që kanë pasur nevojë për

ndërhyrje. Gjithashtu aktualisht te lagjja e Re po punohet të rruga te Kisha. Gjithashtu është segmenti te cirku, segmenti në Banaj që ka filluar tani janë edhe disa segmente të shkurtra dhe me gjithë këto ndërhyrje mbyllt komplet lagjja e Re. Lidhur me lagjen “Naftëtari”, pjesa tjetër që kemi parashikuar që është te OSHEE, jan pallatet e fundit që lidhen me Unazën dhe janë parashikuar që do të ndërhyet nga Agjencia e Shërbimeve Publike. Edhe mbrapa bankës Raiffeisen te lagjja e Re është një pjesë që nuk është ndërhyrë dhe do të fillojnë shumë shpejt punimet. Për sa i përket Rerësit, rruga Rapushajt fillon tani dhe është çështje ditësh. Gjithashtu edhe rruga në Pato lart që është rruga e dyqaneve, janë parashikuar edhe disa rrugë që do të bëhen me ndriçim. Lidhur me pjesën e OSHEE duhet të bisedojmë me institucionin e tyre për shtrimin e linjave pasi është kompetenc e tyre. Në Rusinj për rrugën me çakull i kemi psur mjetet e punës të bllokuara dhe sapo të gjejmë mundësinë do ti dërgojmë për ndërhyrje pasi bazë materiale kemi për ndërhyrje. Lidhur me këndet e lojërave po vlerësojmë që të mos jenë ndërmjet pallateve pasi krijojnë edhe zhurmë për banorët e pallatit, por të jenë pak më larg. Ne kemi të parashikur dy ose tre kënde lojerash për të ndërtuar. Gjithashtu do të filloj edhe rikonstruksioni i kopshtit me drekë dhe besoj se kërkosat për të rregjistruar fëmijë do të shtohen. Kopshti që ndodhet te lagjja e Re nr. 2 do të vlerësohe për tu bërë rikonstruksion ku kati i parë të jetë çerdhe dhe kati i dytë të jetë kopsht.

E parashikuar është edhe rruga “Ali Laze” dhe rruga e “Kripallarëve” që a një projekt të hartuar. Aplikimi i hapësirave poshtë pallateve bësoj se deri në fund të vitit do të janë mbyllur të gjitha. Një aplikim që është për vitin e ardhshëm janë edhe kanalet apo hapësirat që janë përparrë shtëpive private që do të sistemohen dhe pastrohen. Gjithashtu për këtë vit janë parashikur rrith 400 m rrjet i ri i KUZ. Kemi filluar punën për rehabilitimin e murit ekzistues apo rrithimin e varrezave dhe vendosjne e çezmave të ujit dhe do të shtrihet në të gjithë varrezat. Gjithashtu ne jemi duke blerë dhe tumbinot dhe çfarë keni kërkuar ju si kryetarë fshati apo administratorë. Pjesa e Përroit do të vazhdojë dhe do të përfundojë dhe do vazhdoj puna edhe për ndërtimin e shëtitores nga të dyja anët e rrugës dhe do filloj nga rruga “Gani Banaj” dhe do vazhdoj deri te fusha te lagjja e Re. Ndriçimi rrugor do të vazhdojë dhe në rrithinat e Patosit, por duke qenë se kemi hapur shumë kantiere pune njëkohësisht jemi pak të kufizuar te mjetet dhe po ecim me ritme pak më të ngadalta. Gjithashtu është edhe investimi për restaurimin e shkollës “Sotir Çapo” në Zharrëz.

Ju faleminderit!

Banor i fshatit Rerës, z. Bashkim Isufaj – Lidhur me rrugën “Buzaj” nuk dëgjova që ta keni planifikuar. Gjithashtu na duhet edhe ndriçim në këtë rrugë. Edhe për cështjen e transportit lart, ne kemi vetëm një furgon që nuk është i mjaftueshëm.



**Banor i fshatit Rerës
z. Bashkim Isufaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Nëse ne do të shtojmë një furgon tjetër atëherë do të na duhet një kosto shumë e lart për ta mirëmbajtur mjetin dhe për të paguar shoferin. Vet linja nuk e justifikon çmimin që do të duhet për ta përballuar, ndoshta do të duhet të zvendësojmë mjetin me një tjetër me kapacitet për me më shumë veta, por të shtohen dy furgona ka një kosto shumë të lartë.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni më kërkesa apo sugjerime e konsiderojmë të mbyllur këtë dëgjesë publike. Faleminderit për pjesëmarrjen dhe kërkesat tuaja! Do të dëgjohemi në takime të tjera.



Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj

Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

